

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtari Ardian Ajvazi, në çështjen juridike-kontestimore të inicuar me padinë e paditeses [REDACTED] në Prishtinë [REDACTED] kundër të paditurit [REDACTED] nga [REDACTED] Komuna Ferizajt, baza e kontestit rimbursimi i dëmit, me datë 20.09.2016 merrë këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] në Prishtinë [REDACTED] e ushtruar kundër të paditurit [REDACTED] nga [REDACTED] Komuna Ferizajt, lidhur me rimbursimin e dëmit në shumën prej 469.00 Euro.

II. DETYROHET i padituri [REDACTED] nga [REDACTED] Komuna Ferizaj, që paditëses [REDACTED] në Prishtinë [REDACTED] t'ia paguan shumën prej 469.00€ (katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro), në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 19.06.2011, nga i padituri, me kamat ligjore e cila do të llogaritet sipas lartësisë së mjeteve të deponuara që e aplikojne bankat afariste pa destinim të caktuar nga data e ushtrimit të padisë 13.06.2012 e deri në pagesën perfundimtare, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET i padituri [REDACTED] nga [REDACTED] Komuna Ferizaj, që në llogarinë e kësaj Gjykate të paguaj taksën për parashtrimin e padisë në shumën prej 15 Euro si dhe taksën për përpilimin e këtij Aktgjykimi shumën prej 15 Euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të nejjtit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja, përmes përfaqësueses së saj në padi dhe parashtrimet e bëra në seancë, ka pretenduar se i padituri i detyrohet paditëses për rimbursimin e shumës prej 469.00€, për shkak se ai me datë 19.06.2011, ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit rrugor, në të cilin aksident dëmë material në automjet ka pësuar [REDACTED], të cilin paditesja e ka kompensuar, në procedurë tjetër me ujdj jashtëgjyqësore në shumën prej 469.00€. Paditësija, ka shtuar se duke qenë se i padituri, ka shkaktuar aksidentin duke drejtuar automjetin pa mbulesë sigurimi për dëmet që mund të shkaktohen, pasi që i njejtj ditën e aksidentit nuk ka qenë i siguruar, ai ka përgjegjësinë që për këto dëme paditëses t'ia rimbursoj shumat e paguara personave të dëmtuar. Po ashtu paditësija ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata të paditurit e ka ftuar për seancën e datës 20.09.2016, në të cilën ka munguar, kjo shihet në bazë të fletëkthesës së darës 09.08.2016 dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.



Me propozimin e të autorizuarës së paditësës Gjykata ka mbajtur seancën përgaditore dhe atë kryesore në të njejtën ditë.

Gjykata për të vertetuar drejtë gjendjen e fakteve të çështjes, bazuar në nenin 7.1 lidhur me nenin 319.1 të LPK-se, ka bërë administrimin e provave si vijon: Raporti i Aksidentit i datës 19.09.2011, raporti i transferit të mjeteve i datës 22.12.2011, Vendimi i Komisionit mbi Trajtimin e dëmeve i datës 06.07.2011, Urdhër Transferi i datës 15.12.2011, Ujdia Jashtëgjyqësore e datës 15.12.2011, Fondi i Garancisë së Kosovës RE1029/2011, Polisa e Sigurimit për palën e dëmtuar dhe 14 foto të rastit- aksidentit.

Gjykata pasi, ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e provave veç e veç dhe të nderlidhura në tërësi në mes veti, në kuptim të nenit 8.1 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv.

Gjykata ka çmuar, se kërkesëpdia e paditësës përkitazi me lartësinë e pretenduar ka themelësinë në prova materiale, andaj për këto arsye i padituri është përgjegjës për të rimbursuar këtë dëmë që paditësja ka qenë e detyruar ta paguaj ndaj personit që ka pësuar dëmë nga aksidenti i shkaktuar nga i padituri dhe rrejdhimisht, si për pasojë të kesaj, i padituri ka detyrimin që këtë shumë t'ia rimbursion paditësen, në bazë të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshem nga Autopergjegjesia.

Gjykata përkitazi me kamaten ka vendosur bazuar në nenin 277 lidhur me nenin 186 të LMD-se, ndërsa përkitazi me shpenzimet ka detyruar të paditurin që të njejtat t'ia kompensoj paditësës, përkatësisht të paguhen në llogarinë e kësaj Gjykate, dhe ate taksën gjyqësore për padi në shumë prej 15 Euro dhe për aktgjykim shumë prej 15 Euro, bazuar në nenin 452.1 të LPK-së dhe Udhëzimit Administrativ nr.2008/2 për unifikimin e taksave gjyqësore të datës 27.11.2008 dhe ndryshuar me vendimet e KGJK-së me numër 20/2012 dhe 37/2012, të aprovuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Andaj nga të cekurat e më lartë e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.335/12, me date 20.09.2016



KËSHILLA JURIDIKE Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njejt, në Gjyken e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kesaj Gjykate.

